

Engjell Gjugja ka lindur më 1 dhjetor 1989 në qytetin e Gjakovës, në Republikën e Kosovës. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në qytetin e Gjakovës, ndërsa studimet universitare i kreu në Universitetin Papnor Salesian në Romë, Fakulteti Filozofik.

Ka qenë i angazhuar si profesor i Filozofisë/Etikës në gjimnazin jopublik “Maria Ndihtare” në Shkodër. Dëshira dhe përkushtimi për të punuar me të rinjtë shërbeu si trampolinë për punësimin e tij në organizata të ndryshme që realizuan projekte me fokus këtë target grup.

Eksperienca brenda dhe jashtë vendit ndikoi në përmirësimin e shërbimeve të institucioneve publike dhe jopublike nëpërmjet risive që krijuan një klimë mikpritëse për të rinjtë e qytetit.

Ka qenë i angazhuar në implementimin e projekteve me tematika të ndryshme nga zhvillimi dhe ngritja e hapsirave rinore, çështjet e mjedisit, angazhimi i të rinjve në vendimarrje dhe nxitja e të rinjve në kulturë, muzikë, arte dhe teater.

Ai ka qenë President i Kongresit Rinor Kombëtar dhe aktualisht punon në Bashkinë Shkodër si koordinator i Qendrës Rinore Atelie, në administrimin e Bashkisë Shkodër.

Prej vitit 2018, Engjelli mban rolin e koordinatorit vendor të Shkodrës, në kuadër të programit kushtuar politikave rinore në nivel vendor prej tre vitesh të zhvilluar nga Kongresi Rinor Kombëtar në bashkëpunim me Fondacionin Friedrich-Ebert-Stiftung Tirana.

Engjelli zotëron gjuhën Italiane dhe gjuhën Angleze.